



NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Agim Maliqi, kryetar i kolegjit, Rasim Rasimi dhe Afrim Shala, anëtarë të kolegjit, me bashkëpunëtoren profesionale Mirlinda Mejzini Simnica, procesmbajtëse, në çështjen penale ndaj të dënuarve B. S., dhe A. B. për shkak se secili veç e veç kanë kryer veprën penale “*Rrezikimi i trafikut publik*” nga neni 370, paragrafi 9 lidhur me paragrafin 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur sipas kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësve të të dënuarve, të paraqitura kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Përgjithshëm, P.nr.236/2020, të datës 07.04.2023 dhe aktgjyqimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti i Përgjithshëm, PA1.nr.748/2023, të datës 28.09.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur më datën 24.04.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohen si të pabazuara kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësve të të dënuarve B. S. dhe A. B. të paraqitura kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Përgjithshëm, P.nr.236/2020, të datës 07.04.2023 dhe aktgjyqimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti i Përgjithshëm, PA1.nr.748/2023, të datës 28.09.2023.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Përgjithshëm, P.nr.236/2020 e datës 07.04.2023, të dënuarit B. S. dhe A. B. janë shpallur fajtor secili veç e veç për veprën penale “*Rrezikimi i trafikut publik*”, nga neni 370 paragrafi 9 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së dhe ndaj të dënuarit B. S., është shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej (3) viteve, i cili dënim do të ekzekutohet, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë. I është shqiptuar dënimi plotësues marrja e lejes së vozitjes për kategorinë “B” dhe të njëjtit i ndalohet marrja e lejes së re gjatë periudhës prej 2 viteve, duke llogaritur nga dita kur vendimi merr formën e prerë. Koha e kaluar në burg nuk llogaritet në kohëzgjatjen e këtij dënimi. Pas skadimit të këtij afati

i njëjti mund ta marr lejen e re të vozitjes sipas kushteve të përgjithshme. Në dënimin e shqiptuar me burg i llogaritet edhe koha e kaluar në masën e paraburgimit nga data 12.10.2022 deri më datë 04.12.2020.

Të dënuarit A. B. i ka shqiptuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej (2) viteve, i cili dënim do të ekzekutohet, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë. I është shqiptuar dënimi plotësues ndalimi i drejtimit të automjetit në periudhën prej 2 (dy) viteve, duke llogaritur nga dita kur vendimi të merr formë të prerë. Koha e kaluar në burg nuk llogaritet në kohëzgjatjen e dënimit plotësues. Në dënimin e shqiptuar me burg i llogaritet edhe koha e kaluar në masën e paraburgimit nga data 12.10.2022 deri më datë 04.12.2020. Janë obliguar të dënuarit, që t'i paguajnë shpenzimet e procedurës gjyqësore sipas llogaris përfundimtare të gjykatës, secili veç e veç, në emër të paushallit gjyqësor të paguajnë shumën prej 100 € dhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej nga 30 €, ndërsa në mënyrë solidare ti paguajnë shpenzimet në emër të ekspertizës së komunikacionit të datës 11.05.2021, shumën prej 40.38 €, në emër të ekspertizës së komunikacionit të datës 11.05.2021 shumën prej 250 €, në emër të pjesëmarrjes së ekspertit në seancë shumën prej 70 €, në emër të super ekspertizës shumën prej 450 €, në emër të pjesëmarrjes së ekspertëve në seancën e datës 31.03.2022, shumën prej 140 €, në emër të pjesëmarrjes së ekspertëve në seancën e datës 27.02.2023, shumën prej 140 € dhe në emër të ekspertizës mjekoligjore shumën prej 50 €.

Palët e dëmtuara, për realizimin e kërkesës pasurore juridike janë udhëzuar në kontest të rregullt civil.

Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti i Përgjithshëm, me aktgjykimin PA1.nr.748/2023, e datës 28.09.2023, i ka refuzuar si të pabazuara ankesat e mbrojtësve të të dënuarve, ndërsa e ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë kanë paraqitur: Mbrojtësja e të dënuarit B. S., avokatja Teuta Zhinipotoku, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal me propozim që kërkesa të aprovohet si e bazuar, ndërsa aktgjykimet e lartcekura të anulohen dhe kjo çështje penale të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë, apo të nxirret aktgjykim lirues.

Mbrojtësi i të dënuarit A. B., avokati Bledar Gashi, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, nga neni 384, paragrafi 1 dhe 2 dhe 2.6 të KPP lidhur me nenin 369 paragraf i6,7 dhe 8 të KPP-së, dhe shkeljes së ligjit penal, duke propozuar që kërkesa të aprovohet si e bazuar, ndërsa aktgjykimet e lartcekura të anulohen dhe kjo çështje penale të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë dhe

Plotësim të kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë ka paraqitur mbrojtësi i të dënuarit A. B., avokati Granit Hadergjonaj, për shkak të shkeljes së ligjit penal, shkeljes së dispozitave të

procedurës penale, me propozim që kërkesa të aprovohet si e bazuar, ndërsa aktgjykimet e kundërshtuara të anulohen dhe çështja të kthehet në rigjykim.

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, me shkresën KMLP.II.nr.98/2024, e datës 19.03.2024 ka propozuar që kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë të mbrojtësve të dënuarve të refuzohen si të pabazuara.

Gjykata Supreme e Kosovës, pasi i shqyrtoi shkresat e lëndës në seancën e kolegjit, në kuptim të nenit 435, paragrafi 1 lidhur me nenin 436, paragrafi 1 të KPP-së dhe pasi i vlerësoi pretendimet nga kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë, konstatoi se:

-kërkesat janë të pabazuara.

Mbrojtësja e të dënuarit B. S., në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë pretendon se, aktgjykimet e gjykatës së shkallës së parë dhe të gjykatës së shkallës së dytë janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave e procedurës penale nga neni 384, paragrafi 1 dhe 2 pika 2.2 dhe 2.6 të KPP-së lidhur me nenin 369 paragrafi 6, 7 dhe 8 të KPP-së. Më tutje në kërkesë theksohet se të dy gjykatat kanë shkelur të drejtat e mbrojtjes në atë mënyrë që gjykata e shkallës së parë duke e shqyrtuar rastin në seancën përfundimtare dhe pas dorëzimit me shkrim të fjalës përfundimtare të mbrojtësve, gjykata pa e shqyrtuar fare të njëjtën ka shpallur aktgjykimin. Tutje në kërkesë pretendohet se gjykata nuk ka respektuar afatet ligjore të parapara me dispozitat e nenit 365 paragrafi 1 të KPP-së në lidhje me shpalljen e aktgjykimit në afat prej 3 ditësh dhe e njëjta është dashur që detyrimisht ta caktoj afatin maksimal 3 ditor gjatë të cilit do të shqyrtonte pretendimet e palës mbrojtëse dhe vetëm pastaj të jepte verdiktin përfundimtar dhe siç ka vepruar në rastin konkret që të bëjë shpalljen e aktgjykimit pa i shqyrtuar fare pretendimet e palëve mbrojtëse. Më tutje në kërkesën e mbrojtëses theksohet se në dispozitivin e aktgjykimit të shkallës së parë gabimisht është interpretuar pozicioni i personave në aksident dhe është anashkaluar edhe formulimi i dispozitivit nga aktakuza duke tejkalluar atë plotësisht dhe është në kundërshtim me të gjitha vlerësimet e ekspertizave të kryera si dhe super ekspertizën. Pretendohet më tutje në kërkesë se, aktgjykimet janë marr me shkelje të ligjit penal pasi që të njëjtit nuk janë thirrur në asnjë dispozitë relevante të KPP-së.

Mbrojtësi i të dënuarit A. B., në kërkesë pretendon se, dispozitivi i aktgjykimit të shkallës së parë është i pakuptueshëm, kundërthënës me brendinë e tij dhe me arsyetimin e tij, në të nuk janë paraqitur arsyet lidhur me faktet vendimtare, përkatësisht arsyet janë plotësisht të paqarta, kundërthënëse dhe të njëanshme. Tutje ka shtuar se gjykata në këtë çështje penale nuk ka arritur që saktësisht dhe plotësisht të vërtetoj faktet vendimtare apo rrethanat nga të cilat varet zbatimi i drejtë i dispozitës ligjore konform nenit 364 paragrafi 1 të KPP-së dhe me një arsyetim të paqartë dhe kontradiktor, del se aktgjykimi është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 paragrafi 2 nën paragrafi 2.7 lidhur me nenin 369 paragrafi 7 të KPP-së. Pretendohet në kërkesë se aktgjykimet janë marrë

edhe me shkelje të ligjit penal si rezultat i shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, mos vërtetimit të fakteve vendimtare në raport me veprimet e ndërmarra të dënuarit A. B. e të cilat nuk konsistojnë në tejkalimin e shpejtësisë ose ndalimin e tejkalimit të automjetit para tij e si veprime nuk kanë qenë në kundërshtim me rregullat e trafikut ose si të tilla nuk përbëjnë vepër penale. Gjykata e shkallës së parë vetëm ka përshkruar shkeljet por jo duke saktësuar se në çfarë mase kanë kontribuar në aksident të dënuarit veç e veç me veprimet e tyre, pasi që i dënuari A. B. nuk ka vepruar në kundërshtim me rregullat e trafikut dhe se verimet e tij nuk përbejnë figurën e veprës penale. Mbajtësi, po ashtu ka shtuar se, gjykata e shkallës së dytë nuk ka dhënë arsye lidhur me pretendimet ankimore rreth veprimeve të dënuarit A. B., se cili ka qenë kontributi i tij në pasojën por vetëm ka përshkruar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

Në plotësimin e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë mbrojtësi Granit Hadergjonaj, pretendon se, gjykata e shkallës së parë e ka bazuar aktgjykimin në prova të papranueshme, dhe atë si në procesverbalin për marrjen në pyetje të dëshmitarit, ku me rastin e marrjes në pyetje nuk ka qenë prezent mbrojtësi dhe i pandehuri e posaçërisht në vlerësimin e gjendjes faktike pasi që me ekspertizë nuk është e qartë situata dhe përveç kësaj kontributi i tij nuk ka qenë kryesor në këtë çështje. Theksohet më tutje në plotësimin e kërkesës, se gjykata e shkallës së parë nuk e ka marr parasysh faktin se me rastin e aksidentit familja e viktimës nuk kërkon asgjë nga i dënuari dhe po ashtu janë pajtuar sipas dokeve zakonore.

Pretendohet se gjykata ka bërë edhe shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale sipas nenit 384 paragrafi 1 nën paragrafi 1.12 lidhur me nenin 370 të KPP-së, ngase arsyetimi aktgjykimit është kontradiktor me dispozitivin dhe me vetveten si dhe është jo i plotë, gjegjësisht nuk i vërteton të gjitha elementet e veprës penale me të cilën ngarkohet i dënuari. Theksohet në kërkesë se, gjykata e shkallës së parë ka shkelur parimin e barazisë së armëve, pasi gjatë procesit gjyqësor i ka refuzuar provat e propozuara nga parashtruesi, refuzimin nuk e ka arsyetuar fare. Më tutje pretendohet, në plotësimin e kërkesës edhe për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Në pjesën tjetër të plotësimin të kërkesës pretendohet edhe për shkeljen e ligjit penal në dëm të dënuarit A. B. dhe për lartësinë e sanksionit penal që i është shqiptuar të dënuarit.

Gjykata Supreme e Kosovës, pasi i shikoi shkresat e lëndës dhe analizoi pretendimet e mbrojtësve të të dënuarve, konstatoi se aktgjykimet e gjykatës së shkallës së parë dhe të gjykatës së shkallës së dytë, nuk janë të përfshira me ndonjë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe as me shkelje të ligjit penal, siç pretendohet në kërkesat, për arsyet që do të paraqiten në vijim. Si aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, ashtu edhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë përmbajnë të gjitha elementet që kërkohen sipas dispozitave përkatëse ligjore, si në pjesën e dispozitivit, ashtu edhe në pjesën e arsyetimit.

Dispozitivi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë përmban të gjitha elementet e nevojshme, ashtu siç është parashikuar në nenin 369, paragrafët 3 - 4 të KPP-së dhe kjo pjesë

e këtij aktgjykimi, në asnjë rrethanë nuk rezulton që të jetë e paqartë apo në kundërthënie me arsyetimin dhe provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor.

Duke ju referuar pretendimeve të mbrojtësve të dënuarve B. S. dhe A. B., Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se në arsyetimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë janë paraqitur arsye të mjaftueshme për të gjitha pikat e aktgjykimit dhe se përskrimet e dhëna në arsyetim përmbajnë të gjitha arsyet për faktet relevante të cilat janë paraqitur qartë dhe në asnjë mënyrë nuk paraqiten si kundërthënëse apo të mangëta. Nga kjo pjesë e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë rezulton është paraqitur përmbajtja e provave të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, duke përfshirë këtu edhe mendimet dhe konstatimet e ekspertëve të komunikacionit, deklaratimet e dëshmitarëve dhe provave materiale, mandej janë paraqitur gjetjet dhe vlerësimet e gjykatës në lidhje me shumë çështje të rëndësishme në këtë rast.

Nga arsyetimi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë shihet se në këtë rast janë vlerësuar dhe analizuar në mënyrën e duhur të gjitha provat që janë administruar gjatë shqyrtimit gjyqësor, ashtu siç është parashikuar me dispozitat përkatëse ligjore, ku më pastaj, pas një procesi të tillë, janë nxjerrë konkluzionet e caktuara, që kanë të bëjnë si me gjendjen faktike, ashtu edhe aspekte tjera juridike. Në këtë drejtim, rezulton se janë analizuar dhe vlerësuar përveç tjerash, edhe deklaratimet e dëshmitarëve, mendimet dhe konstatimet e ekspertëve të komunikacionit, provat materiale - raporti i autopsisë i datës 02.11.2020, ekspertiza mjeko-ligjore e datës 27.10.2020 e plotësuar me datë 02.02.2021, si dhe janë vlerësuar edhe pretendimet e caktuara të mbrojtjes, ndërsa më pastaj, janë nxjerrë konkluzione të caktuara, të cilat si të drejta dhe të ligjshme pranohen edhe nga Gjykata Supreme e Kosovës.

Sa i përket çështjes së vërtetimi të gjendjes së fakteve, gjykata e shkallës së parë në arsyetimin e aktgjykimit të saj ka paraqitur arsye të mjaftueshme dhe bindëse në lidhje me atë se pse nuk ja kishte falur besimin pretendimeve të mbrojtjes për faktin se nga provat e administruara të theksuara me lartë e nga ekspertizat e komunikacionit duke përfshirë edhe super ekspertizën e grupit të ekspertëve si dhe deklaratimin e tyre gjatë seancës gjyqësore është vërtetuar se deri te aksidenti ka ardhur si pasojë e lëshimeve të dy ngasësve, dhe lëshimet e tyre janë: lëshimet e automjetit “....”- ngasësi i të cilit automjet ka qenë i dënuari B. S.- kanë qenë: a) tejkalimi i shpejtësisë së kufizuar të lëvizjes, ashtu që ka lëvizë me shpejtësi të llogaritur prej 85 kl/h, b) tejkalimi i kolonës së automjeteve në rrugë, në kundërshtim me rregullat e sigurisë në rrugë dhe c) ka drejtuar automjetin me shpejtësi më të madhe se 70 kl/h, si shoferë fillestar dhe lëshimet e ngasësit të automjetit “...” të cilin e ka drejtuar i dënuari A. B. kanë qenë: a) para kalimit majtas për tejkalim nuk është siguruar se a ka ndonjë automjet në tejkalim dhe b) nuk i ka dhënë përparësi kalimi veturës e cila ka qenë duke tejkaluar në rrugë.

Tutje eksperti ka dhënë sqarimet se shpejtësia e lëvizjes së automjetit “....”, ka qenë rreth 85 km/h, ndërsa shpejtësia e veturës “....”, ka qenë rreth 52 km/h. Shpejtësia e kufizuar në atë

segment rrugor ka qenë deri në 50 km/h. Në rastin konkret kemi katër automjete që kanë lëvizur në kahjen e njëjtë, kjo na dërgon në konstatimin se kemi të bëjmë me kolonë dhe sipas ligjit është i ndaluar tejkalimi i kolonës.

Faktin se në atë pjesë të rrugës ishin duke lëvizur 4 automjete, në drejtimin e njëjtë dhe atë: një automjet NN që lëvizte para të dënuarit A. B., pastaj automjeti i të dënuarit A., pas tij një automjet tjetër NN dhe në fund i dënuari B. S., përveç që është pohuar nga të dënuarit në deklaratimet e tyre, ky fakt vërtetohet edhe nga të tri ekspertizat e komunikacionit të hartuara në këtë rast.

Fakti se i dënuari B. S., në ato momente ishte duke tejkaluar një automjet tjetër, që ishte mbrapa të dënuarit A., ndërsa i dënuari A. B. kishte filluar procesin e tejkalimit të një automjeti përpara tij, vërtetohet nga deklaratat e të dënuarve, të dhëna në polici, të cilët i pranojnë këto fakte në tërësi, por që këto janë vërtetuar edhe nga ekspertizat e komunikacionit të hartuara në këtë rast penal.

Nuk ishte kontestues as fakti se e ndjera dhe e dëmtuara në ato momente ishin duke lëvizur në trotuar dhe se këtë fakt nuk e kanë kundërshtuar asnjëri prej të dënuarve, e përveç kësaj kjo vërtetohet edhe nga deklarata e të dëmtuarës F. S. dhe raporti i aksidentit. Për gjykatën e as palët nuk ishte kontestuese as fakti se fëmija-tani e ndjera E. S. si pasojë e goditjes nga vetura “...” kishte pësuar lëndime të rënda trupore, ku fillimisht ishte dërguar në S., ku edhe ishte konstatuar vdekja e saj. Ky fakt nuk është kundërshtuar as nga të dënuarit, e përveç kësaj kjo vërtetohet nga raporti i autopsisë datë 02.11.2020, ku është konstatuar se vdekja e saj ka ardhur si pasojë e gjakderdhjes masive trunore, si pasojë e thyerjeve të shumëfishta në kockat dhe bazën e kafkës. Ndërsa nga ekspertiza mjeko-ligjore e datës 27.10.2020 e plotësuar me datë 02.02.2021 vërtetohet se e dëmtuara F. S. ka pësuar lëndime të rënda trupore.

Edhe i dënuari B. S., në deklarinimin e tij të dhënë në polici e pranon veprimin se ditën kritike e ka vozitur veturën “...”, se ka hyr në tejkalim të një veture para tij, ndërsa vetura tjetër, ... i ka dalur në rrugë, ku është goditur me të, pastaj i ka humbur drejtimi dhe ka dalur jashtë rruge. Edhe i dënuari A. B. në deklarinimin e tij i ka pranuar veprimet e tij, pra ka pranuar se në ato momente ka qenë duke filluar procesin e tejkalimit të një automjeti para tij, por sipas tij lëshimet janë të dënuarit B. për shkak të shpejtësisë së madhe.

Kjo gjykatë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejt ka konstatuar se i dënuari B. S., për shkak të pakujdesisë së tij duke hyr në tejkalim të kolonës së automjeteve, duke vozitur me shpejtësi më të madhe se shpejtësia e lejuar sipas rregullave të komunikacionit dhe duke mos iu përmbajtur kufizimeve të shpejtësisë si shofer fillestar në shkallë të theksuar ka kontribuar në aksidentin me ç, rast si pasojë e goditjes në mes të automjetit “...” dhe “ ...”, ky i fundit humb kontrollin, del në trotuar dhe godet të ndjerën dhe të dëmtuarën, ku si pasojë e goditjes, Fëmija E. S., pëson lëndime të rënda dhe ndërron jetë.” Ndërsa i dënuari A. B. si pasojë e

pakujdesisë së tij me veprimet e tij duke mos u siguruar se tejkalimin mund të bëjë në mënyrë të sigurve dhe nuk i pengon pjesëmarrësit tjerë në komunikacion, ka kontribuar në një masë shkallë të caktuar në shkaktimin e aksidentit.

Kjo është vërtetuar edhe nga super ekspertiza e komunikacionit e hartuar nga grupi i ekspertëve të Fakultetit të Inxhinierisë mekanike të Universitetit të Prishtinës, në të cilën ekspertizë është konstatuar se deri te aksidenti ka ardhur për shkak të lëshimeve të drejtuesve të të dy automjeteve.

Nga super ekspertiza e përpiluar në formë të shkruar, konstatohet se automjeti “...” ka lëvizur me shpejtësi më të madhe se ajo e lejuar, ka tejkaluar kolonën e automjeteve, veprim ky i ndaluar dhe nuk ka respektuar shpejtësinë e kufizuar të vozitjes për shoferët fillestarë, prej 70 km/h. Po ashtu edhe në raport me lëshimet e ngasësit të automjetit “...” është konstatuar se lëshimi i tij ka qenë, përpara se të fillojë tejkalimin nuk është siguruar se a ka ndonjë automjet në tejkalim, ku me këtë veprim e ka penguar automjetin që ka qenë në tejkalim në ato momente. Edhe në lidhje me pikën goditëse dhe vendin ku janë goditur automjetet, gjykata drejt i ka falur besimin super ekspertizës së grupit të ekspertëve, ku në lidhje me këtë rrethanë, ekspertët kanë cekur se bazuar në dimensionet e matura për çdo pikë të treguar me fotografi të vendit të ngjarjes, bazuar në dëmtimet e automjetit “...” si dhe duke pasur parasysh se të dy këmbësorët kanë qenë duke lëvizur në trotuar me gjerësi prej 1.5 m këmbësorët i ka goditur vetura “...” pas përplasen me automjetin “...”.

Pra, siç është vërtetuar deri te aksidenti ka ardhur nga lëshimet e dy pjesëmarrësve, me kontributin e secilit, dhe se sikur mos të ishte kontributi i njërit nuk do të shkaktonte aksidenti. Pra, sikur i dënuari B. të respektonte kufizimet e shpejtësisë, pastaj kufizimet si shoferë fillestarë e gjithësesi edhe kufizimin për mos tejkalim të kolonës së automjeteve, me siguri se nuk do të ndodhte aksidenti, sikur që nuk do të ndodhte edhe në rast se i dënuari A., përpara fillimit të tejkalimit do të ishte siguruar mirë se nuk i rrezikon pjesëmarrësit e tjerë me rastin e fillimit të tejkalimit. Ndryshe siç kanë konstatuar grupi i ekspertëve, sikur vetura “...” të lëvizte brenda shpejtësisë së kufizuar prej 50 km/h, duke pasur parasysh distancën prej 40.3 m nuk do të vinte deri te aksidenti sepse rruga e ndaljes te kjo shpejtësi është 28.6 m që është për 12 metra më e vogël.

Përkitazi me pretendimet e mbrojtjes se lëvizja me një shpejtësi më të madhe se ajo e lejuar, nuk e bënë përgjegjës, penalisht për aksidentin, ky pretendim është i pabazuar. Shkelja e rregullave në trafikun rrugor përbën shkelje kundërvajtësve, mirëpo gjykata tërheq vërejtjen secilit, se shkelja e rregullave në trafik ka pasoja penale vetëm në rastet kur shkaktohet pasoja e ndaluar sipas KPRK-së, e që në rastin konkret është lëndimi i rëndë trupor i të dëmtuarës F. S. dhe vdekja e fëmijut E.. Në çdo rast dhe çfarëdo shkelje apo mosrespektim i shenjave në komunikacion si pasojë e të cilave shkaktohet ndonjë pasojë e paraparë me KPRK, atëherë në rastin e tillë kemi vepër penale dhe se personi përgjigjet penalisht, brenda dashjes apo pakujdesisë së tij.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, të dy gjykatat me provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, drejtë kanë vlerësuar se të dënuarit si ngasës të automjeteve të lartcekura duke mos iu përmbajtur rregullave dhe kufizimeve në trafikun rrugor me veprimet e tyre nga pakujdesia kanë ardhur deri tek pasoja e shkaktuar. Tutje, të dy gjykatat drejtë kanë gjetur se veprimet e të dënuarve kanë qenë në kundërshtim me Ligjin për Rregullat të Trafikut Rrugor, respektivisht veprimet e të dënuarit B. S. janë në kundërshtim me dispozitat e LRrTRr ku parashihet se shoferi duhet tua përshtatë shpejtësinë e lëvizjes kushteve dhe fushëpamjes së rrugës, gjendjes dhe llojit të rrugës, kushteve teknike, kushteve atmosferike, ngarkesës së mjetit, dendësisë së trafikut, gjendje psikofizike të tij dhe aftësive personale të tij, ashtu që të jetë në gjendje ta ndalë mjetin para çdo pengese që të mund të paraqitet, përkatësisht të mund të veprojë me kohë. Sipas neni 73 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 ndalohet tejkalmimi i këtyre mjeteve 1.2 i kolonës së mjeteve si dhe në kundërshtim me nenin 235 paragrafi 1 të njëjtit ligj ku është përcaktuar se : shoferit të ri dhe fillestar i ndalohet të drejtojë mjetin në auto udhë me shpejtësi më të madhe se njëqind e dhjetë km/h në moto udhë me shpejtësi më të madhe se 80 km/h në rrugët e tjetra me shpejtësi më të madhe se 70 km/h.

Veprimet e të dënuarit A. B. janë në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, ku përcaktohet se shoferi, i cili në rrugë ose në ndonjë hapësirë tjetër të trafikut synon të bëjë ndonjë veprim me mjet si hyrjen në trafik, rreshtimin, lëvizjen e mjetit në anën e djathtë ose të majtë, ndërrimin e shiritit të trafikut, tejkalimin, anashkalimin, ndalimin e mjetit, kthimin në anën e djathtë apo të majtë, kthimin gjysmë rrethor, drejtimin e mjetit mbrapa e të ngjashme, lejohet të fillojë një veprim të tillë vetëm nëse më parë është i bindur se nuk i rrezikon ose nuk i pengon pjesëmarrësit tjerë në trafik ose nuk e rrezikon pasurinë si dhe neni 68 përcakton se para fillimit të tejkalimit, shoferi duhet të sigurohet se shoferi i mjetit që lëviz prapa tij nuk e ka filluar veprimin e tejkalimit.

Pretendimi i mbrojtëses të dënuarit B. S., se gjykata nuk ka respektuar afatet ligjore të parapara me dispozitat e nenit 365 paragrafi 1 të KPP-së në lidhje me shpalljen e aktgjykimit, është i pabazuar, për faktin se gjykata e shkallës së parë, në pajtim me nenin 365 paragrafi 1 të KPP-së, e ka bërë shpalljen e aktgjykimit menjëherë pasi e ka marr aktgjykimin, e jo ashtu siç pretendon mbrojtja, ndërsa kur gjykata nuk ka mundësi që në të njëjtën ditë pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor ose të seancës të merr aktgjykim, shpalljen e aktgjykimit e shtyn më së shumti për 3 ditë.

Përkitazi me pretendimet e mbrojtësit të dënuarit A. B., të paraqitura në plotësimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë se gjykata nuk ka dhënë arsyetim të mjaftuar lidhur me refuzimin për dëgjimin e dëshmitarit të propozuar nga mbrojtja, kjo gjykatë vlerëson se pretendimi është i pabazuar për faktin se gjykata e shkallës së parë në arsyetimin e aktgjykimit ka dhënë arsyetim të mjaftueshëm, me arsyetimin se mbrojtja për këtë propozim nuk ka ofruar arsye të mjaftueshme se cilat fakte konkrete do të provohen dhe pse janë të rëndësishëm këta dëshmitar, për çështjen penale, vetëm pretendimi se janë dëshmitar nuk

është i mjaftueshëm, por se në çdo rast duhet të ceket saktë se cili fakt duhet të provohet dhe rëndësia e atij fakti për çështjen penale.

Lidhur me pretendimin se aktgjykimi përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale sipas nenit 129 paragrafi 6 të KPP-së, se është bazuar në prova të papranueshme për faktin se në procedurën paraprake me rastin e dëgjimit të dëshmitarit nuk ka qenë prezent as mbrojtësi e as i dënuari, po ashtu është i pabazuar.

Dispozita e nenit 119 paragrafi 3 të KPP-së përcakton se “ deklarata në procedurë paraprake pranohet gjatë shqyrtimit kryesor për marrje të drejtpërdrejt në pyetje, marrje të tërthortë në pyetje dhe rimarrje në pyetje. Dëshmia në procedurën paraprake mund të përdoret si provë e drejtpërdrejt në shqyrtimin kryesor nëse dëshmitari nuk është në dispozicion për shkak të vdekjes, sëmundjes, privilegjeve apo mos pranisë së tij në Kosovë, vetëm nëse të pandehurit ose mbrojtësit i është dhënë mundësia e kundërshtimit përmes marrjes në pyetje të dëshmitarit gjatë ndonjë faze të procedurës penale, e që nga shkresat e lëndës dhe aktgjykimi i kundërshtuar rezulton se gjykata aktgjykimin e ka mbështetur në prova të pranueshme, në dëshminë e të dëmtuarve B. B., F. S., dëshmitarve I. S. Z. S. dhe provave të tjera materiale të theksuara si më lartë e të cilat prova janë të pranueshme dhe në pajtim me dispozitat ligjore të cilat janë administruar gjatë shqyrtimit gjyqësor, të cilat kanë mundur të kundërshtohen nga i pandehuri dhe mbrojtësi gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor. Pra, (në rastin konkret nuk qëndron pretendimi se gjykata e ka mbështetur aktgjykimin vetëm në një dëshmi apo një prove tjetër e cila nuk mund të kundërshtohet nga i pandehuri ose mbrojtësi përmes marrjes në pyetje gjatë ndonjë faze të procedurës, por siç u sqarua më lartë mbrojtësit dhe të pandehurit i është dhënë mundësia që dëshmitë e tilla të kundërshtohen në fazën e shqyrtimit gjyqësor, prandaj këto nuk paraqesin prova të papranueshme siç pretendohet pa të drejt nga mbrojtja.

Lidhur me pretendimin e mbrojtësit të dënuarit në një pjesë të kërkesës për konstatimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, kjo Gjykatë nuk është lëshuar në vlerësimin e kësaj shkelje, për faktin se në nenin 432 par.2 të KPPK, është përcaktuar se “ kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk mund të ushtohet për shkak të konstatimit të gabuar ose jo të plotë të gjendjes faktike, andaj kërkesa e ushtruar për këtë bazë, është e palejuar.

Po ashtu, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës pretendimet e mbrojtësve të dënuarve për shkeljen e ligjit penal janë të pabazuara. Kjo Gjykatë, vlerëson se me aktgjykimet e gjykatave të instancave më të ulëta nuk është shkelur as ligji penal në dëm të të dënuarve B. S. dhe A. B., sepse nuk është vërejtur se ekziston ndonjë rrethanë që do ta përjashtonte përgjegjësinë penale apo ndjekjen penale të të dënuarve. Të dy gjykatat drejtë kanë vlerësuar se në veprimet e të dënuarve konsumohen të gjitha elementet e veprës penale për të cilën janë shpallur fajtor dhe se në rastin konkret është aplikuar ligji penal që ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale dhe se në mënyrë të drejtë janë aplikuar dispozitat ligjore për caktimin e llojit dhe matjes së lartësisë së dënimit për të dënuarit.

Sa i përket pretendimeve të mbrojtjes lidhur me sanksionin e shqiptuar të dënuarve, sipas vlerësimit të kësaj Gjykate në arsyetimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë janë theksuar të gjitha rrethanat që kanë ndikuar në shqiptimin e llojit dhe lartësisë së dënimit. Përndryshe, duhet theksuar faktin se nuk është në kompetencë të Gjykatës Supreme të Kosovës shqyrtimi i lartësisë së dënimeve të shqiptuara, por e rëndësishme është se me rastin e shqiptimit të dënimit nuk janë tejkuluar kompetencat ligjore, kështu që pretendimet e mbrojtësve në këtë drejtim nuk qëndrojnë.

Megjithatë, bazuar në dispozitën e nenit 385, paragrafi 5. të KPP, kur është fjala për vendimin për dënim, shkelje e ligjit penal bëhet vetëm në rastet kur gjykata i ka tejkuluar kompetencat ligjore me rastin e shqiptimit të dënimit, ndërsa në rastin konkret nuk ka ndodhur një gjë e tillë.

Në rast se nuk është fjala për këtë shkelje, vendimi për dënimin me këtë mjet të jashtëzakonshëm juridik, mund të kundërshtohet vetëm nëse kjo pjesë e aktgjykimit është marr me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale e cila do të mund të ndërli dhej me mungesën ose paqartësitë e arsyeve lidhur me vendimin për dënimin, mirëpo, në rastin konkret një pretendim i këtillë në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk është paraqitur.

Duk u bazuar në arsyet e cekura më lart dhe në bazë të nenit 437 të KPP-së është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Pml.nr.169/2024, më datë 25.03.2024

Procesmbajtës,
Bujar Balaj

Kryetar i kolegjit,
Agim Maliqi